



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 tetor 2015  
Nr. ref.: RK 847/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI29/15**

Parashtrues

**Bardhyl Kameri**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 9/2015, të 12 shkurtit 2015**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bardhyl Kameri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Koretin, komuna e Kamenicës, i cili përfaqësohet nga z. Halit Azemi.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 9/2015, i 12 shkurtit 2015. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 mars 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre, gjatë caktimit të dënimit me burgim, kanë shkelur nenin 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 10 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI29/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI29/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 29 prill 2015, Gjykata informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja, me Vendimin GJR. KI29/15 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues, në vend të gjyqtares Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 1 korrik 2015, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI29/15 caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit si gjyqtar kushtetues kishte përfunduar më 26 qershor 2015.
10. Më 10 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 19 qershor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, me Aktgjykimin, P. nr. 193/2011, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 i Kodit Penal të Kosovës, duke i shqiptuar dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.
12. Më 18 gusht 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së Prokurorit Publik në Gjilan, me Aktgjykimin PAI. nr. 997/2014, aprovoi kërkesën e Prokurorit Publik përkitazi me vendimin për dënim, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës masën e burgimit efektiv në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. Më tej, në Aktgjykim theksohet *“Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit janë të bazuara, sepse rrethanat lehtësuese në rastin konkret janë mbivlerësuar ndërsa rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar fare, se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore dhe pasojat e veprës së kryer”*.
13. Më 6 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan, duke vepruar sipas kërkesës së parashtruesit për zëvendësimin e dënimit me burg me masën e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, nxori Aktvendimin P. nr. 193/11, duke hedhur poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit.
14. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin PN. nr. 645/2014, refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktvendimit, P. nr. 193/11 të Gjykatës Themelore në Gjilan.
15. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Supreme, duke vepruar në bazë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 193/11, të 11 qershorit 2014, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 645/2014, të 16 dhjetorit 2014, nxori Aktgjykimin, Pml. nr. 9/2015, nëpërmjet të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit. Gjykata Supreme konstatoi se Gjykata e shkallës së dytë kishte shqiptuar dënimin në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi në kohën e shqiptimit të dënimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me shqiptimin e dënimit me burgim janë shkelur nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.
17. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të prishë vendimet e gjykatave të rregullta dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.

## Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

20. Gjykata, gjithashtu, thekson nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

21. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.*

22. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale nga ana e gjykatave të rregullta, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

23. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka treguar se si këto vendime kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* e cila do të theksonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).

24. Gjykata në vazhdim thekson se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

25. Parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij në Gjykatën Themelore në Gjilan, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.
26. Siç u përmend më lart, Gjykata vëren se arsyetimet e dhëna në Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 193/11, të 11 qershorit 2014, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN. nr. 645/2014, të 16 dhjetorit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 9/2015, të 12 shkurtit 2015, janë të plota dhe të qarta. Prandaj, Gjykata gjeti se procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituaniës*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
27. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të mbështesë me prova, se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.
28. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij
29. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shtator 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi